



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 49, Datë 23.03.2022

MBI

SHTYRJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S MBI APLIKIMIN E SHOQËRISË “KARAVASTA SOLAR” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME VENDNDODHJE NË ZONËN E REMASIT - KARAVASTA, LUSHNJE DHE LIBOFSHË, FIER, ME KAPACITET TË INSTALUAR 140 MW

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 13, pika 1 dhe 3, dhe nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.03.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 382/1 prot., datë 17.03.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, “Mbi shtyrjen e afatit të vendimarrjes së bordit të ERE-s mbi aplikimin e shoqërisë “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me vendndodhje në zonën e Remasit - Karavasta, Lushnje dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140 MW”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 261, datë 21.12.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me vendndodhje në zonën e Remasit – Karavasta, Lushnje dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140 MW.
- Me shkresën nr. 1129/2 prot., datë 30.12.2021, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimarrjen e bordit të ERE-s e po ashtu për zhvillimin e një seance dëgjimore më datë 10.01.2022, ora 14:00, për të sqaruar dokumentacionin e konstatuar si të munguar apo të plotësuar pjesërisht. Në seancë është ftuar dhe OST sh.a., me qëllim sqarimin e fazës në të cilën ndodhet procedura për marrjen e miratimit përfundimtar të pikës së lidhjes së impiantit të shoqërisë “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k. me rrjetin e transmetimit.

- Pas zhvillimit të seancës dëgjimore, shoqëria “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k. ka depozituar dokumentacion dhe informacion me shkresën e protokolluar në ERE nr. 48/2 prot., datë 27.01.2022.
- Dokumentacioni i depozituar nga shoqëria “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k. nuk plotësonte tërësisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, ndaj ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 48/3 prot., datë 15.02.2022, duke i evidentuar dokumentat që mbeten pa u plotësuar tërësisht dhe/ose kanë nevojë për informacion shtesë. Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, është parashikuar dhe zgjatja e afatit për pranimin ose refuzimin për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për aplikuesin rasti pas rasti, konkretisht:
 3. *Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shume se 30 ditë pune.*
- Duke qenë se shoqëria “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k. ka plotësuar një pjesë të konsiderueshme të dokumentacionit të kërkuar nga Rregullorja, vlerësohet që të zgjatet me 30 (tridhjetë) ditë pune afati i vendimmarrjes së bordit mbi aplikimin e shoqërisë për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke i dhënë kështu mundësinë shoqërisë që të plotësojë dhe dokumentacionin e mbetur ende pa u plotësuar i cili duhet të depozitohet brenda 20 (njëzet) ditëve pune.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë me 30 (tridhjetë) ditë pune afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi aplikimin e shoqërisë “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me vendndodhje në zonën e Remasit- Karavasta, Lushnje dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140 MW.
2. Shoqëria “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k. të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar brenda 20 (njëzet) ditëve pune.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHHMETI